Udhëzues për kalimin nga standardi ISO 14001:2015 përfshirë Amd 1:2024 në ISO 14001:2026

Zbatues: Stafi i DPA-së, vlerësuesit teknik dhe organet certifikues të sistemeve të menaxhimit të mjedisit

Përgjegjës për zbatim: Drejtori i Drejtorisë së Organeve Certifikuese dhe Inspektuese

Kontrolloi: Menaxheri i Cilësisë
Ardita MELE

Miratoi: Drejtori i Përgjithshëm
Pranvera FAGU

1 Qëllimi

Ky dokument përshkruan udhëzime për kalimin nga standardi ISO 14001:2015 përfshirë Amd 1:2024 në ISO 14001:2026. Ky dokument është i vlefshëm për DPA dhe vlerësuesit e saj si dhe për organet certifikuese të sistemeve të menaxhimit të mjedisit të akredituar nga DPA, organet certifikuese të sistemeve të menaxhimit te mjedisit që kanë aplikuar për akreditim apo që kanë për qëllim të aplikojnë për akreditim. Ky dokument është i vlefshëm deri në datën 30 Prill 2029.

2 Fusha e zbatimit

Ky udhëzues zbatohet nga vlerësuesit dhe stafi i DPA, nga nënkontraktuesit e saj për vlerësimin e organeve certifikuese që kryejnë certifikim të sistemeve të menaxhimit te mjedisit në përputhje me këtë standard.

3 Përgjegjësitë

Ky udhëzues është pjesë e sistemit të menaxhimit të DPA dhe si i tillë është nën përgjegjësinë e Drejtorit të Drejtorisë së Zhvillimit rishikimi i vazhdueshëm në varësi të ndryshimeve të duhura dhe përmirësimeve të vazhdueshme në sistemin e menaxhimit të DPA. Drejtori i Drejtorisë së Organeve Certifikuese dhe Inspektuese ka detyrë të kontrollojë zbatimin e këtij udhëzimi.

4 Referimet

Kjo procedurë i referohet**:**

- Standardi S SH ISO/IEC 17011:2017,
- Politika DA-PO-002

5 Përkufizime

Në këtë udhëzues është përdorur terminologjia e standardit SSH ISO/IEC 17011:2017

DPA - Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit

6. PËRMBAJTJA

6.1. TË PËRGJITHSHME

DPA ka vendosur një periudhë tranzitore 3 vite (36 muaj) nga data e publikimit për kalimin nga standardi ISO 14001:2015 përfshirë edhe Amd 1:2024 në standardin ISO 14001:2026. Periudha e tranzicionit për standardin ISO 14001:2026 do të vazhdojë deri më datë 30 Prill 2029. DPA duhet ta përfundojë vlerësimin e procesit të tranzicionit të organeve certifikuese të sistemeve të menaxhimit te mjedisit nga ISO 14001:2015 përfshirë edhe Amd 1:2024 në standardin ISO 14001:2026 jo më vonë se data 30 Prill 2027. Nëse një organ certifikues i akreditуar nuk përfundon në mënyrë të suksesshme vlerësimin e tranzicionit deri në datën 30 Prill 2027, vlefshmëria e akreditimit sipas ISO 14001:2015 përfshirë edhe Amd 1:2024 përfundon në datën 30 Prill 2029.

Organi certifikues i akreditуar, pas tranzicionit të susksesshëm, nuk mund të leshojë më certifikata të reja sipas ISO 14001:2015.
OVK duhet ta përfundojë procesin e tranzicionit nga ISO 14001:2015 përfshirë Amd 1:2024 në standardin ISO 14001:2026 të klientëve të saj të certifikuar deri më datë 30 Prill 2029.
DPA ka të drejtën për të bërë çdo shtesë dhe/ose ndryshim nëse versioni përfundimtar i dokumentit Global ACI prezanton kërkesa të ndryshme.

6.2 VEPRIMET E ORGANIZMIT AKREDITUES.

DPA do të trajnojë vlerësuesit, kryevlerësuesit, specialistët e dosjeve, vendimmarrësit, anëtarët e grupit teknik të punës përkatës në lidhje me kërkesat e ndryshuara dhe të reja të ISO 14001:2026 si dhe me procesin e tranzicionit. DPA do të jetë gati për të filluar aktivitetet e akreditimit/tranzicionit në përputhje me standardin e ri ISO 14001:2026 brenda datës 31 Tetor 2026.
Për rastin e organeve certifikuese që kanë aplikuar për akreditim sipas ISO 14001:2015 përfshirë Amd 1:2024 përpara datës 31 Tetor 2026 dhe vizita vlerësuese nuk është kryer deri me datë 30 Prill 2027, vlerësimi nga DPA do të kryhet sipas standardit ISO 14001:2026.
Për organet certifikuese të akredituara me ISO 14001:2015 përfshirë Amd 1:2024, DPA do të shqyrtojë ndryshimet, analizat e mangësive të cdo organi certifikues të akreditуar sipas skemës së certifikimit ISO14001:2026, planet e tranzicionit/zbatimit, dokumentacionin e ndryshuar ku të reflektohen ndryshimet sipas versionit të ri të ISO 14001, autorizimet e personelit për ISO 14001:2026, evidencat e zbatimit të ISO 14001:2026 dhe cdo informacion tjetër që DPA mund t'ju kërkojë organeve certifikuese. Organet certifikuese të akredituara nga DPA do të dërgojnë dokumentacionin e mësipërm jo më vonë se data 31 Janar 2027.

Shqyrtimi i dokumentacionit nga ana e DPA do të llogaritet një ditë pune dhe do të paguhet nga organi certifikues i akreditуar. Në rastet kur është e nevojshme DPA organizon vizitë në zyrat e organit certifikues. Vleresimi ne zyre pas marrjes së vendimit per tranzicionin duhet te fokusohet ne verifikimin e zbatimit te planit te tranzicionit dhe deklarates perkatese, duke perfshire ecurine e tranzicionit te klienteve te certifikuar. Kohëzgjatja e vizitës bazohet në analizën e riskut. Vizita në organin certifikues për vlerësimin e tranzicionit të ISO 14001:2026 mund të jetë gjatë vizitës mbikëqyrëse ose në një vizitë shtesë. Pas marrjes së vendimit të tranzicionit, nevojitet kryerja e të paktën një vlerësimi me deshmi sipas standardit ISO 14001:2006 perpara dates se perfundimit te tranzicionit te ketij standardi me date 30 Prill 2029.

DPA do të përditësojë informacionin e akreditimit të organeve certifikuese të akredituara (p.sh. programin e akreditimit), nëse kompetenca e tyre për ISO 14001: 2026 është demonstruar.

Organet certifikuese të akredituara nga DPA për këtë skemë duhet të plotësojnë vetëdeklarimin për tranzicionin sipas Shtojcës A të këtij Udhëzuesi. Ato duhet te paraqesin vetëdeklarimin për kalimin në ISO 14001:2026 perpara datës 31 Janar 2027. DPA do të marrë vendimin e tranzicionit në përputhje me deklaratën (Shtojca A) e këtij Udhëzuesi dhe dokumentacionin mbështetës të ofruar nga organi certifikues. Vendimet per tranzicionin, përfshirë lëshimin e dokumentave të akreditimit (psh certifikatës), duhet të përfundojnë brenda 12 muajve (30 P'rill 2027). Kur është e nevojshme mund të kryhen veprime shtesë të ndjekjes gjatë aktiviteteve të zakonshme të planifikuara të vlerësimit. Në raste të rrethanave të jashtëzakonshme ose bazuar në analizën e riskut, sipas gjykimit të DPA, DPA mund të kërkoje aktivitete shtesë të tranzicionit përpara marrjes së vendimit për tranzicionin. Për shembull nëse akreditimi i një organi certifikues është i pezulluar, vendimi për tranzicionin mund të mos jetë i mundur të merret vetëm mbi bazën e një deklarate dhe përpara marrjes së vendimit, mund të kërkohen veprime të mëtejshme (psh një vlerësim)

Vlerësimi në zyrën e organit certifikues duhet të fokusohet në verifikimin e zbatimit të marrëveshjes së tranzicionit pavarësisht se kjo marrëveshje nuk është zbatuar plotësisht. Vlerësimi në zyrë duhet të përfshijë të paktën:

• Zbatimi i proceseve dhe procedurave të rishikuara të organit certifikues-së.

• Kompetenca e personelit (trajnimi dhe kualifikimi) përkatës është demonstruar para se të ishin përfshirë në aktivitetet e certifikimit kundrejt ISO 14001:2026.

• Ecuria e tranzicionit për klientët e certifikuar kundrejt standardit ISO 14001: 2026.

Vlerësimet me dëshmi të planifikuara për tu zhvilluar pas vendimit për kalimin e tranzicionit do të bazohen në standardin ISO14001: 2026 duke vënë fokusin në vlerësimin e kompetencës së auditorëve për të kryer auditimet kundrejt ISO 14001: 2026. Nëse një organ certifikues i akreditуar nuk dëshiron të kalojë në rishikimin e ri të këtij standardi, organi duhet të informojë DPA-në deri më datë 31 Tetor 2026 dhe organi certifikues do t'i tërhiqet akreditimi në fund të tranzicionit.. Nëse organi certifikues i akreditуar vendos të mos kalojë në tranzicion, organi certifikues duhet t'i informojë klientët e prekur për këtë vendim brenda

datës 31 Tetor 2026.

6.3 VEPRIMTARITË E ORGANEVE CERTIFIKUESE

Organi certifikues duhet të krijojë planin e tranzicionit për ISO 14001:2026 duke marrë parasysh kërkesat e këtij standardi dhe rregullat e përcaktuara për tranzicionin nga DPA. Plani i tranzicionit do të përcaktojë se çfarë do të bëjë organi certifikues dhe çfarë do të bëjë klienti.

Rekomandohet që Organet e Certifikimit të:

a) Planifikojnë dhe të përgatiten për të aplikuar tek DPA për tranzicionin dhe të bëhen gati për zbatimin e kërkesave të reja sipas afateve të përcaktuara në këtë udhëzues.
b) Zhvillojnë një plan tranzicioni duke përfshirë cështjet e mëposhtme:

- Idenfikimin e ndryshimeve ndërmjet versionit të ri dhe atij të vjetër të standardit dhe analizën e mangësive. Proceset e konsideruara për ndryshime mund të përfshijne shitjet/kuotimin, procesin e auditimit, menaxhimin e kompetencave dhe komunikimin aktiv gjatë procesit të tranzicionit me klientet ekzistues të certifikuar ne lidhje me procesin e tranzicionit, veprimet e pritshme dhe afatet kohore.

- Analizimin e impaktit të ndryshimeve në aktivitetet/proceset përkatëse dhe identifikimin e veprimeve të kërkuara për të siguruar përputhshmërinë me kërkesat e versionit të ri të standardit (psh. Sistemi i menaxhimit/ dokumentat, IT, implementimi i veprimeve korrigjuese;

- Sigurimin që personeli përkatës i prekur nga ndryshimet eshte i trajnuar dhe kompetent sipas versionit të rishikuar dhe procesin e tranzicionit. Persoeneli përkates mund të përfshijë personelin e shitjeve, auditorët, rishikuesit teknike, vendimmarrësit apo rishikuesit e kontratës/aplikimit;

- Grupi i auditimit, në tërësi, duhet të ketë njohuri për standardin ISO 14001:2026 dhe zbatimin e kërkesave të këtij standardi;

- Programi i auditimit të tranzicionit;

- Përcaktimin e komunikimit në kohë me klientin për programin e tranzicionit, të tilla si afati kohor, percaktimin e auditimit të tranzicionit dhe pasojat nëse klienti nuk arrin të kalojë përpara përfundimit të periudhës së tranzicionit;

c) Fillimin e veprimeve të nevojshme sa më shpejt që të jetë e mundur.

Organet certifikuese mund të kryejnë auditimin e tranzicionit gjatë auditimeve të mbikqyrjes, të ricertifikimit ose nëpërmjet një auditimi të veçantë. Auditimi i tranzicionit nuk duhet të mbështetet vetëm në rishikimin e dokumentave.

Auditimi i tranzicionit përfshin, por nuk kufizohet në:

- Analiza e mangësive të ISO 14001: 2026.
- Nëse është e aplikueshme, përditësimi i planit të trajtimit të rrezikut.
- Zbatimi dhe efektiviteti i kontrolleve të reja ose të ndryshuara te mjedisit të zgjedhura nga klientët.

Organi certifikues mund të kryejë edhe nje auditim në distancë mjafton që të plotësohen objektivat e auditimit të tranzicionit.

Organet certifikuese mund të përcaktojnë afatin kohor për dorëzimin e aplikimit për tranzicionin nga klientët e certifikuar në programin e auditimit të tranzicionit. Organi certifikues duhet të marrë vendimin e tranzicionit bazuar në rezultatin e auditimit të tranzicionit.

Të gjitha certifikatat e lëshuara kundrejt ISO 14001:2015 përfshirë edhe Amd 1:2024 duhet të skadojnë ose tërhiqen në fund të periudhës së tranzicionit.

Nëse një klient i prekur (p.sh. i çertifikuar) zgjedh të mos kalojë në fazën e tranzicionit, organi certifikues mund të kryejë auditimin në versionin e mëparshëm. Në këtë rast, organi certifikues duhet të informojë klientin e saj mbi vlefshmërinë e çertifikimit që përfundon në fund të periudhës së tranzicionit.

6.4. CERTIFIKIMET E ORGANEVE CERTIFIKUESE.

Certifikimet e reja dhe ricertifikimet:

Organet certifikuese duhet të përdorin versionin e ISO 14001: 2026 për certifikim fillestar apo ricertifikim vetëm pas akreditimit të tyre sipas ISO 14001: 2026.

SHTOJCA A
Deklarata e Organit të Vlerësimit të Konformitetit të Akredituar për ISO 14001:2026

Unë (emer mbiemer) deklaroj se nga data e kësaj deklarate, OVK (emri i OVK më poshtë):

- Ka implementuar ndryshimet e kërkuara sipas këtij tranzicioni,
- Përputhet me kërkesat e nevojshme për tranzicionin, dhe
- Mund të demonstrojë evidencë të implemetimit.

Une pranoj më tej se:

- DPA, nga e cila është akredituar OVK-ja, do të shqyrtojë zbatimin e tranzicionit përkundrejt kësaj deklaratë në vlerësimin/vlerësimet e ardhshme.
- Një deklaratë që është e rreme ose nuk mund të vërtetohet përbën shkelje të kritereve të akreditimit dhe është bazë për korrigjimet dhe veprimet korrigjuese të kërkuara. Nëse nuk zgjidhet sic duhet brenda afateve të caktuara, kjo do të jetë bazë për pezullim ose tërheqje.
- Aktivitetet e mëposhtme janë përfunduar:
  - Plani i tranzicionit
  - Dokumentacioni i rishikuar për të mbështetur tranzicionin dhe/ose kërkesat e rishikuara.
  - Kompetenca e nevojshme është përcaktuar në dokumentin e rishikuar dhe OVK-ja ka auditorë dhe personel tjetër të mjaftueshem (psh, shqyrtues aplikimi, vendimmarrës për certifikim) që konsiderohen kompetentë për të mbështetur programin e rishikuar te certifikimit.
  - OVK-ja ka një proces për të përcaktuar kohëzgjatjen e auditimit që mbështet programin e rishikuar të certifikimit (nëse është e aplikueshme).
  - OVK-ja ka një proces për të menaxhuar kontrollin e certifikimeve sipas versionit të rishikuar, dokument që përfshin a) lëshimin e certifikatave të akredituara vetëm pas vendimit të tranzicionit të DPA dhe b) menaxhimin e datave të duhura të përfundimit të afatit të certifikatave të lëshuara më parë.

Nënshkrimi:	
Emri:	
Titulli:	
Emri i OVK:	
Data:	